Ref. 2015-COS-0844

Znj. Igballe Rogova
Drejtore ekzekutive
Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
Prishtinë

Prishtinë, më 4 shtator 2015

E nderuar znj. Rogova,

Ju falënderoj për letrën tuaj të hapur, të 27 gushtit 2015, në lidhje me përfshirjen e EULEX-it në zhvarrosjen e kryer kohëve të fundit në varrezat e Krushës së Vogël.

Fillimisht, dëshiroj t'i përsërisë ngushëllimet tona të sinqerta për familjet e viktimave të vrara ose të zhdukura gjatë masakrës në Krushë të Vogël. Ju sigurojë se EULEX-i mbetet fuqimisht i angazhuar në përmbushjen e mandatit të tij, në përputhje të plotë me Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për të kontribuuar në kërkimin e Kosovës për personat e zhdukur si dhe për të hetuar, ndjekur penalisht dhe për të gjykuar rastet e krimeve të luftës.

Duhet të mbetet objektiv i Departamentit të Mjekësisë Ligjore (DML) që, si autoritet kompetent, të sqarojë fatin e personave të zhdukur. Unë sinqerisht ndjejë keqardhje për çfarëdo shqetësimi që mund të jetë shkaktuar nga këto ngjarje. Llogaris në mirëkuptimin tuaj që puna e rëndësishme që kryhet nga DML-ja ndonjëherë përfshinë operacione për të cilat ne e kuptojmë se mund të jenë veçanërisht të rënda për familjet e personave të zhdukur, por megjithatë janë të domosdoshme për të sjellë qartësinë përfundimtare.

Unë mund të ju sigurojë se personeli i DML-së dhe i EULEX-it ka qenë gjithmonë i interesuar që t'i informojë familjet për secilin hap të ndërmarrë, e veçanërisht në rastet kur është bërë ndonjë identifikim apo në rastet kur është dashur të bëhet ndonjë ri-zhvarrosje. Është synim i tyre që të takohen me familje, shoqata të familjeve si dhe me persona të tjerë të përfshirë në këtë çështje apo të cilët mund të ndihmojnë në zgjidhjen e rasteve të personave të zhdukur.

Pavarësisht kësaj që u tha më sipër, unë kam urdhëruar personelin tim që në kuadër të DML-së t'i diskutojnë shqetësimet tuaja legjitime dhe të shikojnë se cila është mënyra më e mirë për t'i kontaktuar familjet edhe një herë.

Ju falënderoj për mirëkuptimin tuaj në këtë çështje të ndjeshme dhe ju lus për mbështetjen tuaj që t'i kontaktojmë dhe t'ua shpjegojmë familjeve në fjalë këto që u than më sipër.

Sinqerisht,

[nënshkrimi]
Gabriele Meucci
Shef i Misionit
EULEX Kosova

EULEX Kosova
Selia e misionit
Rr. Muharrem Fejza,
Kutia postare: 268
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0) 38 78 2000
Faks: +381 (0) 38 78 4556
www.eulex-kosovo.eu
info@eulex-kosovo.eu